



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

PRISHTINË, 14 DHJETOR 2010
NR.REF.: RK 45/10

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI 67/09

**Parashtruesi
Idriz Ratkoceri**

VLERËSIMI I KUSHTETUTSHMËRISË

të

**Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë, P. 1216/2004,
i datës 03 shkurt 2006**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi

1. Parashtruesi është z. Idriz Ratkoceri, me vendbanim në Obiliq.

Vendimi i sfiduar

2. Vendimi i sfiduar nga parashtruesi është Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë Nr. P. 1216/2004, i datës 03 shkurt 2006.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi kërkon nga Gjykata të vlerësojë kushtetutshmërinë e aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë Nr. P. 1216/2004, të datës 03 shkurt 2006. Përveç këtij aktgjykimi, parashtruesi i referohet edhe aktgjykimeve vijuese:
 - a. Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Nr. Ap.203/06, të datës 8 maj 2007;
 - b. Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Pkl. nr. 56/07, të datës 20 tetor 2008; dhe
 - c. Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Pkl. nr. 106/2009, të datës 23 prill 2010.

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës, Neni 20 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i datës 16 dhjetor 2009 (Nr. 03/L-121), (në tekstin e mëtutjeshëm “Ligji”) dhe Neni 54 (b) i Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtutjeshëm “Rregullorja e Punës”).

Procedurat para Gjykatës

5. Më 3 dhjetor 2009, parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtutjeshëm “Gjykata”).
6. Më 16 mars 2010, kërkesa në fjalë i është komunikuar Gjykatës Supreme, e cila deri më sot nuk ka paraqitur asnjë koment.
7. Më 14 dhjetor 2010, pas shqyrtimit të raportit të Gjyqtarit raportuese, Ivan Čukalović, Kolegji shqyrtues i përbërë nga gjyqtari Robert Carolan (Kryesuesi), Zëvendëskryetari Kadri Kryeziu dhe gjyqtarja Iliriana Islami, ia rekomanduan atë Gjykatës së plotë.

Përmbledhje e fakteve

8. Më 03 shkurt 2006, Gjykata Komunale në Prishtinë nëpërmjet Aktgjykimit P. Nr. 1216/2004, dënoi parashtruesin me një vit e gjysmë burg për punime ndërtimore të paligjshme, që përcaktohet me Nenin 294 (1) të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (në tekstin e mëtutjeshëm “KPPK”) në lidhje me Nenin 23 të KPPK dhe urdhroi parashtruesin të paguajë shumën prej 103 459 62 Marka gjermane (52 898 06 Euro).
9. Gjykata Komunale vendosi që më 11 qershor 2001, parashtruesi së bashku me të birin e tij, kishte rrezikuar jetën dhe trupin e personit të tretë duke rindërtuar një ndërtesë në Obiliq pa leje, dhe kështu i kishte shkaktuar dëme të konsiderueshme pronës së atij personi.
10. Parashtruesi ishte ankuar në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë kundër aktgjykimit të Gjykatës Komunale, duke pretenduar shkeljen thelbësore të dispozitave të procedurës penale, vlerësimit të gabuar të gjendjes faktike dhe shkeljen e KPPK. Ai po ashtu, atakoi vendimin e gjykatës në lidhje me dëmin e shkaktuar dhe pagimin e

kompensimit. Më 8 maj 2005, Gjykata e Qarkut shpalli që ankesa ishte e pabazë dhe njëkohësisht miratoi aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë.

11. Parashtruesi ishte ankuar kundër këtij aktgjykimi në Gjykatën Supreme, që më 20 tetor 2008 gjeti se ankesa ishte e pabazë dhe njëkohësisht miratoi aktgjykimet e gjykatave të lartpërmendura.
12. Më 23 shtator 2009, Prokurori Shtetëror parashtroi në Gjykatën Supreme një kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër vendimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, duke pretenduar që dispozitat e aktgjyimit në fjalë nuk janë të qarta dhe që janë në kundërshtim me faktet e rastit.
13. Më 23 prill 2010, Gjykata Supreme refuzoi kërkesën e Prokurorit Shtetëror për mbrojtjen e ligjshmërisë si të pabazë.

Pretendimet e parashtruesit

14. Parashtruesi pretendon që vendimet e gjykatave të rregullta janë të paligjshme për arsye të mëposhtme:
 - a. Se ai nuk ka të bëjë asgjë me rindërtimin e ndërtesës, që ishte subjekt i procedurës penale, për shkak se ai jeton në shtëpinë e tij në rrugën "Meto Bajraktari" nr. 20 në Obiliq që nga viti 1965, ndërsa i biri i tij jeton në rrugën "Hasan Prishtina" në Prishtinë;
 - b. Se i biri i tij kishte një leje ndërtimi (Leje urbane Nr. 04-351-519, 21 maj 2002); dhe
 - c. Se rindërtimi i ndërtesës nuk kishte rrezikuar ndërtesën e personit të tretë.
15. Për këto arsye, parashtruesi pretendon që ai është dënuar me burg për një vepër penale që nuk e ka kryer dhe se të drejtat e tij kushtetuese janë shkelur.
16. Parashtruesi nuk thekson qartë se cilat nene të Kushtetutës janë shkelur në rastin e tij.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

17. Në mënyrë që të jetë në gjendje të vendosë për kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet së pari të kontrollojë nëse parashtruesi ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë, Ligj dhe Rregulloren e Punës.
18. Sipas njërës prej kriterëve, parashtruesi duhet të dëshmojë që ai ka dorëzuar kërkesën brenda periudhës kohore prej 4 muajsh, siç përcaktohet me Nenin 49 të Ligjit. Megjithatë, në bazë të dokumentacionit të paraqitur nga parashtruesi, del që vendimi i fundit gjyqësor për rastin e tij ishte Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, i datës 20 tetor 2008, që atij i është dorëzuar më 13 nëntor 2008. Ndërsa ai ka dorëzuar kërkesën në Gjykatën Kushtetuese më 03 dhjetor 2009, që i bie të jetë 4 muaj pas hyrjes në fuqi të Ligjit (shih Nenin 56 të Ligjit).
19. Ndonëse është e vërtetë që më 23 prill 2010 Gjykata Supreme mori vendim mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, të dorëzuar nga Prokurori Shtetëror më 23 shtator 2009, i cili nuk ishte palë ndërgjyqësore, kjo procedurë nuk mund të merret parasysh për shkak të llogaritjes së periudhës kohore prej 4 muajsh në lidhje me

procedurat gjyqësore në rastin e parashtruesit (shih *mutatis mutandis*, Brumarescu kundër Romania, Kërkesa 28342/95, Aktgjykim i datës 28 tetor 1999, paragrafi 62).

20. Sipas këtyre rrethanave, nuk mund të konsiderohet që parashtruesi ka përmbushur kriteret e Nenit 49 të Ligjit.

21. Gjithashtu, Gjykata i referohet Nenit 48 të Ligjit që përcakton se:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

22. Sipas Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese nuk mund të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt kur shqyrton vendimet e marra nga gjykatat e rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta të interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës materiale dhe asaj procedurale (shih *mutatis mutandis*, García Ruiz kundër Spanjës [GC], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).

23. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse dëshmitë që janë paraqitur, dhe nëse procedurat në përgjithësi, vështuar në tërësinë e tyre, janë zbatuar në mënyrë që parashtruesi të gëzojë një gjykim të drejtë (shih, ndër burimet tjera, Raportin e Komisionet Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, Kërkesa nr. 13071/87, miratuar më 10 korrik 1991).

24. Parashtruesi nuk ka paraqitur prova prima facie, që dëshmojnë se janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë (shih Vanek kundër Republika e Sllovakisë, Vendim i GJEDNJ mbi Pranueshmërinë e Kërkesës nr. 53363/99, 31 maj 2005), siç edhe përcaktohet me Nenin 113.7 të Kushtetutës dhe Nenin 48 të Ligjit.

25. Në bazë të kësaj, rrjedhimisht kërkesa është e pabazë.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në bazë të Nenit 113.7 të Kushtetutës, 48 të Ligjit, si dhe Nenit 54 (b) të Rregullores së Punës, në seancën e datës 14 dhjetor 2010, njëzëri:

VENDOS

- I. TË REFUZOJË kërkesën si të papranueshme.
- II. Ky vendim do t'ju komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me Nenin 20 (4) të Ligjit.
- III. Ky vendimi hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari Raportues

Ivan Čukalović, d.v.



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. Dr. Enver Hasani, d.v.